



Rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare

Fusha: Artet

3. Konceptet kryesore tematike të fushës dhe përshkrimi i tyre

Meqë artet e ndryshme kanë specifikat e tyre, janë identifikuar disa koncepte të përbashkëta tematike të fushës Artet, që janë të shtrira në 4 dimensione kryesore përgjatë gjithë sistemit arsimor nga klasa 0-12. Konceptet e njejta vazhdojnë të shtrihen edhe në këtë nivel në katër tërësi tematike kryesore. Ato janë:

Krijimtaria dhe performanca artistike – këtu kemi të bëjmë me pjesëmarrjen në veprimtaritë artistike kryesore përmes të cilave nxënësit inkurajohen të krijojnë dhe performojnë në aktivitete artistike, individualisht ose në grup, sipas prirjeve, dispozitave dhe interesave të tyre si p.sh: Këndimi, luajtja në ndonjë instrument muzikor, kompetenca krijuese në disiplina të ndryshme të arteve pamore, në dramë, vallëzim etj. Konceptet pra janë vetë veprimtaritë, performanca, vepra, shfaqja, etj.

Gjuha dhe komunikimi artistik - *Gjuha artistike* ka të bëjë me mjetet (elementet) e ndryshme shprehëse (tingujt, vijat, ngjyrat, ritmi, melodia, etj.) dhe rregullat/ parimet (drejtpeshimi, perspektiva, harmonia, saktësia, etj.) me të cilat nxënësit mësojnë t'i njohin, kuptojnë dhe t'i zbatojnë ato për qëllim të komunikimit artistik në mënyra dhe nivele të ndryshme.

Komunikimi artistik - ka të bëjë me format dhe metodat që i mundësojnë nxënësve për të përjetuar, njohur, kuptuar dhe përdorur gjuhën artistike me qëllim të komunikimit të lirë artistic për tema të ndryshme, idetë dhe ndjenjat personale. Në këtë nivel nxënësit inkurajohen që të përdorin edhe teknika të kombinuara e bashkëkohore artistike (instalacion dhe videoinstalacion, videoperformancë, mjuzikll, drame muzikore, valle modern etj).

Relacioni art-shoqëri – këtu kemi të bëjmë me trajtimin e artit në kontekstin historik dhe shoqëror (lokal, regjional, kombëtar, global etj). Nxënësit identifikojnë dhe përjetojnë vepra artistike nga gjini, zhanre, stile, vepra, ngjarje, institucione artistike në periudha të ndryshme historike e në kontekste të ndryshme shoqërore (lokale, regjionale, kombetare, globale etj.). Në kuadër të temave e njësive mësimore nxënësit njohin edhe disa nga krijuesit dhe interpretet më të shquara dhe zhvillimet artistike kryesore që kanë lënë gjurmë në shoqëri, gjithmonë në përputhje me mundësitë përjetuese dhe moshës së nxënësve.

Këtu kemi të bëjmë me konceptet artistike si: gjinitë ose llojet artistike, zhanre, stile, kryevepra artistike në periudha të ndryshme stilistike si edhe struktura, ngjarje e institucione artistike

etj. P.sh. instrumentet muzikore, ansamblet, formacionet, gjinitë (muzika vokale, muzika instrumentale, muzika skenike), zhanret dhe stilet (klasicizmi, romantizmi, impresionizmi etj). Brenda këtyre identifikohen krijues interpretë, institucione më të shquara të periudhës së caktuar historike e stilistike etj. Kurse për artet pamore: gjinitë dhe teknikat (vizatimi, piktura, skulptura, arkitektura, grafika, dizajni, multi-media, instalacioni, portreti, peizazhi, kolazhi, mozaiku, dizajni, moda, enterieri etj), zhanre dhe stile (klasicizmi, baroku, impresionizmi, etj.). Në kuadër të kësaj nxënësit njohin krijimtarinë e përfaqësuesve më të denjë në nivel botëror dhe kombëtar, duke i identifikuar specifikat dhe ngjashmëritë në më shumë detaje dhe të ndërlidhura me zhvillimet shoqërore historike.

Çmuarja dhe vlerësimi estetiko-artistik ka të bëjë me një proces të vazhdueshëm në mësimin artistik që përfshin çdo temë, njësi e orë mësimore dhe përmes së cilit synojmë t'i aftësojmë nxënësit që të përdorin konceptet e mësuara për të gjykuar dhe vlerësuar krijimin dhe performimin artistik vetanak dhe të tjerëve.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS ARTET
Shkalla kurrikulare 1
<p>1. Krijimtaria dhe performanca artistike</p> <p>Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj.</p> <p>Nxënësi /ja merr pjesë në aktivitete të ndryshme artistike sipas interesimit dhe prirjes individuale:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Këndon këngë e melodi të thjeshta sipas imitimit; 2. ritmizon vargje, ritme (me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë); 3. Vizaton, ngjyros, e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në temë të caktuar; 4. Imiton, reciton, interpreton role të thjeshta në dramatizim; 5. lëviz në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj; 6. Përmes lojës imagjinon e krijon melodi, ritme, shoqërime, lëvizje e vallëzime në mënyrë të lirshme, origjinale dhe creative ose në temë të caktuar
<p>2. Gjuha dhe komunikimi artistik</p> <p>Nxënësit njohin dhe përdorin elementet dhe parimet e gjuhës artistike, proceset dhe teknikat themelore të krijimtarisë artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe në vallëzim.</p>
<p>Nxënësi/ja:</p>

- Përmes përceptimit dhe përjetimit artistik njih (vëren) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse, p.sh: *përmes dëgjimit muzikor, vrojtimit të veprave artistike në tekste, katalogje, në ekspozita, në videoprezantime, në internet etj.) dhe në krijimet e veta vëren dhe dallon tingullin, vijat, ngjyrën, ritmin, melodinë, formën, dimensionin, raportin, kontrastin, teksturën etj.).*

3. Relacioni art – shoqëri

Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjelltas në kontekstin historik, social dhe kulturor.

Nxënësi/ja:

1. Vëren dhe identifikon lloje të ndryshme të arteve (p.sh. muzikën vokale, instrumentale, portretin, peizazhin etj.).
2. Vëren dhe identifikon llojet e institucioneve artistike (galeri, teatër, muze, sallë koncertale etj.).
3. Emërton disa (se paku 4 krijues, interpretë të njohur të gjinive e zhanreve të ndryshme të krijimtarisë artistike globale e kombëtare

4. Çmuarja dhe vlerësimi estetiko-artistik

Nxënësit aplikojnë gjykim dhe vlerësim kritik të veprave artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe vallëzim, duke u bazuar në të kuptuarit e filozofisë së artit dhe parimet estetike.

Nxënësi/ja:

1. Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjatë bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje, mimikë, me mjete shprehëse të tjera etj.
2. Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetanake dhe të tjerëve me fjalor shumë të thjeshtë (p.sh. *ai/ajo këndoi mirë, pastër, më pëlqejnë ngjyrat që ke përdor, nuk e ke vizatuar mirë formën e topit etj.*).

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS: ARTET

Shkalla kurrikulare 2

1. Krijimtaria dhe performanca artistike

Nxënësit ,sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj.

Nxënësi/ja zhvillon shkathtësitë performuese (interpretuese) në një apo në më shumë veprimtari artistike:

1. Këndon individualisht dhe në grup, këngë e melodi sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole (lule, flutura, katrorë etj.)
2. ritmizon vargje, ritme me zë dhe me vegla muzikore sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole;
3. Krijon forma të ndryshme dy dhe tridimensionale duke përdorur teknika të ndryshme figurative dhe aplikative
4. luan në instrumente muzikore fëmijërore (të Orfit dhe popullore) sipas prirjes dhe mundësive interpretuese (muzike)
5. lëviz dhe vallëzon sipas muzikës së dëgjuar, tekstit dramatik ose mesazhit artistik që dëshirojnë të shprehin
6. Krijon ritme e melodi me zë ose instrumente muzikore në bazë të ritmit ose tekstit poetik;
7. Krijon lëvizje origjinale kreative sipas muzikës, tekstit letrar ose situatës së caktuar; (vallëzim, dramë)
8. Krijon elemente origjinale në interpretimin e rolit të caktuar dhe paraqitjes skenike.

2. Gjuha dhe komunikimi artistik

Nxënësit njohin dhe përdorin elementet dhe parimet e gjuhës artistike, proceset dhe teknikat themeloretë krijimtarisë artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe në vallëzim.

Nxënësi/ja

1. Identifikon dhe përdor në mënyrë origjinale dhe kreative elementet artistike për komunikim artistik të ideve e mesazheve të tyre, p.sh, njeh dhe përdor mënyra të ndryshme të trajtimit të elementeve shprehëse (ritmin, melodinë, harmoninë, formën, dinamikën, tempon, karakterin shprehës, vijat, ngjyrat, formën, lëvizjet, gjestet, emocionin etj.) për të komunikuar idetë personale, mesazhet, emocionet etj.

3. Relacioni art - shoqëri

Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjelltas në kontekstin historik, social dhe kulturor.

Nxënësi/ja:

1. Rinjeh vepra artistike ndaj të cilave është ekspozuar gjatë mësimit (rinjeh këngën, veprën muzikore, pikturën etj.).
2. Emërton dhe dallon gjinitë dhe zhanret e ndryshme artistike
3. Prezanton funksionin e disa institucioneve të ndryshme artistike
4. dallon, krahason dhe prezanton krijues përformues dhe formacione interpretuese të zhanreve dhe stileve të ndryshme artistike në nivel kombëtar dhe global.

4. Çmuarja dhe vlerësimi estetiko-artistik

Nxënësit aplikojnë gjykim dhe vlerësim kritik të veprave artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe vallëzim, duke u bazuar në të kuptuarit e filozofisë së artit dhe parimet estetike.

Nxënësi/ja:

1. Çmon dhe vlerëson krijimet dhe performancat artistike (vetanake dhe të tjerëve) duke përdorur terminologji adekuate dhe konceptet e fushës
2. Komenton veprat artistike dhe shquan elementet karakteristike shprehëse të përdorura p.sh. *ky vizatim është i mirë, ose forma e pemës nuk është mirë, për shkak se....ai/ajo këndoi mirë me ritëm por melodia nuk ishte e saktë* etj. (Mua nuk më pëlqen që ke përdorur me tepri ngjyrën x, sepse...pra me gjykim kritik për aq sa lejon moshën dhe aftësia e tyre përjetuese e veprave)

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS: ARTET

Shkalla kurrikulare 3

1. KRIJIMTARIA DHE PERFORMANCA ARTISTIKE

Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj.

Demonstron prirje për të zhvilluar ndonjë ose disa shkathtësi artistike në muzikë, dramë, arte pamore e vallëzim

Nxënësi/ja:

1. Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, këngë dhe melodi të thjeshta sipas imitimit dhe me tekst notal;
2. Interpreton pjesë nga role /personazhe të ndryshme (dramë, komedi);
3. Interpreton individualisht ose në grup vallëzime me karakter të ndryshëm.

Krijon duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse artistike për të shprehur përjetimin individual, ndjenjat dhe idetë personale

Nxënësi/ja:

1. vizaton, ngjyros, modelon (me laps, ngjyra, plastelinë, letër e materiale të tjera) në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në tema të caktuara;
2. Improvizon në mënyrë kreative mbi melodi e ritme të njohura më parë;
3. krijon melodi, ritme, këngë e shoqërime instrumentale të këngëve;

4. krijon lëvizje origjinale e kreative gjatë vallëzimit;
5. Krijon elemente origjinale e kreative në rolet, dialogët sipas temës së caktuar.

2. GJUHA DHE KOMUNIKIMI ARTISTIK

Nxënësit njohin dhe përdorin elementet dhe parimet e gjuhës artistike, proceset dhe teknikat themelore të krijimtarisë artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe në vallëzim.

Nxënësi/ja

1. Përdor elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta
2. Zbulon dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementëve të gjuhës artistike.
3. Eksperimenton dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike
4. Komunikon me mjetet shprehëse artistike përkatëse (muzikë, dramë, vallëzim dhe arte vizuale) në mënyrë të përshtatshme për audiencë të ndryshme (kolegë, prindër, fëmijë të tjerë, publik më i gjerë etj.).
5. Njeh tradita të ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.

3. RELACIONI ART – SHOQËRI

Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjelltas në kontekstin historik, social dhe kulturor.

Nxënësi/ja:

1. Identifikon dhe emërton vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme;
2. identifikon dhe dallon zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj.

4. ÇMUARJA DHE VLERËSIMI ESTETIKO-ARTISTIK

Nxënësit aplikojnë gjykim dhe vlerësim kritik të veprave artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe vallëzim, duke u bazuar në të kuptuarit e filozofisë së artit dhe parimet estetike.

Nxënësi/ja:

1. Komenton dhe shprehet për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, prezantim e forma të tjera shprehëse
2. Komenton krijimet/performimet e veta dhe të tjerëve, duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate
3. Çmon veprat e trashëgimisë kulturore –popullore në ambientin ku jeton

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS: ARTET

Shkalla kurrikulare 4

1. KRIJIMTARIA DHE PERFORMANCA ARTISTIKE

Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj.

Shquhet me aftësi individuale performuese (interpretuese) në një apo në më shumë veprimtari artistike

Nxënësi/ja

1. Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë);
2. Interpreton në tërësi role (karakterë) të ndryshme;
3. Interpreton në performanca të ndryshme të kombinuara (muzikë, dramë, vallëzim).

Krijon duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të arteve përkatëse

Nxënësi/ja

4. vizaton, ngjyros, modelon peizazh, portret, kompozicione dy e tridimensionale etj., në mënyrë të lirshme ose me temë të caktuar;
5. Krijon këngë dhe shoqërimi instrumentale në zhanre të ndryshme (popullore, artistike, argëtuese);
6. Krijon koreografi origjinale sipas muzikës, tekstit ose situatës së caktuar;
7. Krijon dhe kontribuon në realizimin skenik të teksteve për shfaqje të ndryshme (dramë, komedi, mjuzikll).

2. GJUHA DHE KOMUNIKIMI ARTISTIK

Nxënësit njohin dhe përdorin elementet dhe parimet e gjuhës artistike, proceset dhe teknikat themelore të krijimtarisë artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe në vallëzim.

Nxënësi/ja

1. Përdorin në mënyrë efektive njohuritë e tyre mbi elementet, proceset dhe teknikat interpretuese dhe krijuese artistike duke i përdorur ato në mënyrë të vetëdijshme në krijimet e tyre vetjake.
2. Komunikojnë me vetëbesim dhe siguri para audiencave të ndryshme, duke kombinuar format dhe mjetet shprehëse të arteve edhe me ndihmën e teknologjisë (prezantime multimediale, instalacione etj.).
3. Dallojnë aplikimet e inovacioneve në teknika shprehëse dhe medime bashkëkohore të artit (si video arti, Instalacioni, Performanca etj.), në veprat e artit bashkëkohor.
4. Komunikojnë me vetëbesim dhe siguri me mjetet shprehëse artistike përkatëse (muzikë, dramë, vallëzim dhe arte vizuale) për audience të ndryshme (kolegë, prindër, fëmijë të tjerë, publik më i gjerë etj.).
5. Analizojnë dhe krahasojnë traditat e ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.

3. RELACIONI ART – SHOQËRI

Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjelltas në kontekstin historik, social dhe kulturor.

Nxënësi/ja

1. Njeh në mënyrë më të kompletuar kryeveprat artistike në nivel kombëtar dhe botëror;
2. Demonstron të kuptuarit e ndërlidhjes në mes zhvillimeve shoqërore në periudha të ndryshme kohore dhe ndikimit në stilet, zhanret, format, formacionet dhe elementet shprehëse artistike (p.sh., baroku, klasika, romantizmi etj., dhe karakteristikat dalluese ose specifikat e krijimtarisë artistike muzikore, figurative në këto stile).
3. Prezanton disa nga përfaqësuesit më të spikatur të stileve e periudhave artistike në nivel global dhe lokal e kombëtar

4. ÇMUARJA DHE VLERËSIMI ESTETIKO-ARTISTIK

Nxënësit aplikojnë gjykim dhe vlerësim kritik të veprave artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe vallëzim, duke u bazuar në të kuptuarit e filozofisë së artit dhe parimet estetike.

Nxënësi/ja

1. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar formën, elementet shprehëse dhe mënyrat e teknikat e përdorimit të tyre në funksion të shprehjes artistike.
2. Përjeton, analizon dhe vlerëson në mënyrë kritike elementet karakteristike dalluese të kryeveprave artistike të trashëgimisë kulturore dhe artistike (muzikore, pamore, dramë, vallëzim) në kontekst kombëtar dhe më të gjerë
3. Çmon diversitetin kulturor në rajon dhe më gjerë

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS: ARTET

Shkalla kurrikulare 5

1. KRIJIMTARIA DHE PERFORMANCA ARTISTIKE

Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj.

Nxënësi/ja

1. Performojnë pjesë (këngë, valle, pjesë teatrale) të formave, gjinive dhe zhanreve të ndryshme muzikore, duke aplikuar teknika më të avancuara interpretuese dhe kombinuar teknikat interpretuese në disiplinat e ndryshme artistike.
2. Krijojnë vepra artistike duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse për të komunikuar dhe shprehur përjetimet, ndjenjat dhe idetë personale.
3. Prezantojnë aftësitë e tyre krijuese dhe interpretuese në klasë dhe para një audience të

caktuar me vetëbesim dhe siguri.

2. GJUHA DHE KOMUNIKIMI ARTISTIK

Nxënësit njohin dhe përdorin elementet dhe parimet e gjuhës artistike, proceset dhe teknikat themelore të krijimtarisë artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe në vallëzim.

Nxënësi/ja

1. Përdorin elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta përmes veprave artistike në nivel më të avancuar
2. Eksperimentojnë dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të nivelit më të avancuar.
3. Komunikojnë me mjetet shprehëse artistike përkatëse (muzikë, dramë, vallëzim dhe arte vizuale) në mënyrë të përshtatshme për audienca të ndryshme (kolegë, prindër, fëmijë të tjerë, publik më i gjerë etj.).

3. RELACIONI ART – SHOQËRI

Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjelltas në kontekstin historik, social dhe kulturor.

Nxënësi/ja

1. Identifikojnë dhe elaborojnë me shkrim, me gojë ose me forma të tjera të prezantimit, rolin e artit dhe të zhvillimeve artistike në kontekstin kulturor dhe atë historik në periudhat e ndryshme të zhvillimit shoqëror.
2. Përcaktojnë ndikimin e kontributit të individëve të shquar në artet e ndryshme të kulturave të ndryshme përgjatë historisë.
3. Përshkruajnë dhe kategorizojnë vepra të ndryshme të artit dhe objekte të trashëgimisë kulturore sipas periudhës historike, kulturës, stilit dhe artistit.
4. Njohin dhe krahasojnë tradita të ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.

4. ÇMUARJA DHE VLERËSIMI ESTETIKO-ARTISTIK

Nxënësit aplikojnë gjykim dhe vlerësim kritik të veprave artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe vallëzim, duke u bazuar në të kuptuarit e filozofisë së artit dhe parimet estetike.

Nxënësi/ja

1. Demonstrjnë të kuptuarit se si artet komunikojnë ide përmes vlerave personale dhe shoqërore të inspiruara nga imagjinata individuale dhe konteksti historik, kulturor dhe social i krijuesit.
2. Zhvillojnë mendimin e tyre kritik dhe analitik për të vlerësuar veprat e ndryshme të artit në aspektin estetik.
3. Zhvillojnë aftësinë e shijimit dhe përjetimit të veprave artistike duke kultivuar dhe rafinuar shijen e tyre estetike në art.
4. Krijojnë kulturën debatuuese për diskutimin dhe trajtimin e çështjeve dhe problemeve të artit.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS: ARTET

Shkalla kurrikulare 6

1. KRIJIMTARIA DHE PERFORMANCA ARTISTIKE

Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj.

Nxënësi/ja

1. Interpretojnë individualisht dhe në grup, duke zbatuar teknika të kombinuara të interpretimit artistik në përputhje me karakterin shprehës dhe stilistik të veprës dhe zhanrit artistik përkatës (muzikë, dramë, vallëzim, prezantime sinkretike dhe multimediale etj.).
2. Krijojnë vepra (muzikore, figurative, dramë/lojë teatrale dhe vallëzim) për situata të ndryshme, duke përdorur edhe teknologjinë dhe medium të ndryshme dhe duke manipuluar në mënyrë të vetëdijshme me elementet shprehëse artistike përkatëse.
3. Prezantojnë krijimet e tyre artistike edhe para një publiku më të gjerë, duke demonstruar vetëbesim, siguri dhe të hapur për vlerësime kritike dhe reflektim të punës së tyre krijuese/interpretuese.

2. GJUHA DHE KOMUNIKIMI ARTISTIK

Nxënësit njohin dhe përdorin elementet dhe parimet e gjuhës artistike, proceset dhe teknikat themelore të krijimtarisë artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe në vallëzim.

Nxënësi/ja

1. Sintetizojnë njohuritë e tyre mbi gjuhën artistike proceset dhe teknikat duke i përdorur ato në mënyrë të vetëdijshme në krijimet e tyre vetjake
2. Dallojnë aplikimet e inovacioneve në teknika shprehëse dhe medime bashkëkohore të artit (si video arti, Instalacioni, Performanca etj.), në veprat e artit bashkëkohor.
3. Komunikojnë me mjetet shprehëse artistike përkatëse (muzikë, dramë, vallëzim dhe arte vizuale) për audienca të ndryshme (kolegë, prindër, fëmijë të tjerë, publik më i gjerë etj.).

3. RELACIONI ART – SHOQËRI

Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjelltas në kontekstin historik, social dhe kulturor.

Nxënësi/ja

1. Elaborojnë karakteristikat dalluese të rrymave dhe drejtimeve artistike (të së kaluarës, moderne dhe postmoderne apo bashkëkohore) në periudha të ndryshme historike.
2. Krahasojnë zhvillimet e ndryshme historike, kulturore e teknologjike dhe ndikimi i tyre në arte dhe anasjelltas.
3. Identifikojnë zhvillimet dhe inovacionin në arte në periudhën bashkëkohore dhe ndikimin në normat, vlerat dhe rendin shoqëror.
4. Krahasojnë dhe prezantojnë traditat e ndryshme artistike në periudha të ndryshme

historike.

4. ÇMUARJA DHE VLERËSIMI ESTETIKO-ARTISTIK

Nxënësit aplikojnë gjykim dhe vlerësim kritik të veprave artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe vallëzim, duke u bazuar në të kuptuarit e filozofisë së artit dhe parimet estetike.

Nxënësi/ja

1. Interpretojnë dhe identifikojnë simbolizmat dhe metaforat e përdorura në veprat artistike të kulturave dhe periudhave të ndryshme historike.
2. Reflektojnë mendimin dhe gjykimin e tyre mbi një vepër arti, përmes formave të ndryshme të shprehurit si përmes shkrimit (esesë), poezisë etj.
3. Analizojnë dhe vlerësojnë krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.
4. Kultivojnë kulturën debatuuese me tone kritike konstruktive për trajtimin e zhvillimeve aktuale në arte.